




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-14683

Dt: 25.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve, Përfundimit 01. Nr.06-9885-8/2 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt. 24.02.2016, me të cilën është miratuar kërkesë e OJQ Shoqata e të Shurdhërve të Gjakovës për ndihmë financiare për vazhdimin e aktiviteteve dhe veprimtarisë së kësaj shoqate, me dt: 25.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së të Shurdhërve të Gjakovës, e evidentuar me nr. 01-400-1662 e dt: 13.01.2016, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj, duke e ndihmuar me subvencione të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vlerë prej 1.000€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1.000€, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhironlogarinë e Shoqatës së të Shurdhërve në Gjakovë, nr. 1505001003024255 Raiffeisen Bank .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
  - Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
  - Z. Burim Ibrahim, kryetar i Shoqatës së të Shurdhërve në Gjakovë, rr. "Anton Qetta " nr. 2 .
  - Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

